

ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË



**Linearizimi i menaxhimit të aseteve në Institucionet e
Varësisë të Bashkisë Tiranë**

Version 5.0

FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT

Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit

| Data | Autori | Versioni | Shënime mbi Rishikimet |
|----------|--------|----------|------------------------|
| 4.4.2017 | | 1.0 | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

NËNSHKRIMET MIRATUESE

Të dhënat e personit të Kontaktit:

<Në tabelën e mëposhtme duhet të paraqitet informacioni në lidhje me zyrtarin që përgatit specifikimet teknike.>



Permbledhja

| | |
|--|----|
| Permbledhja | 3 |
| 1. HYRJE..... | 5 |
| 1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues | 5 |
| 1.2. Historiku | 5 |
| 1.3. Situata Aktuale në Sektor | 6 |
| 2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA..... | 6 |
| 2.1. Objektivi i Përgjithshëm | 6 |
| 2.2. Qëllimi..... | 7 |
| 2.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori | 7 |
| 3. SUPOZIMET DHE RISQET..... | 8 |
| 3.1. Supozimet e Projektit..... | 8 |
| 3.2. Risqet..... | 8 |
| 4. QËLLIMI I PUNËS | 8 |
| 4.1. Të Përgjithshme..... | 8 |
| 4.1.1. Përshkrimi i detyrës | 9 |
| 4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet | 9 |
| 4.1.3. Grupet e synuara | 9 |
| 4.1.4. Siguria e sistemit..... | 9 |
| 4.2. Detyrat specifike..... | 11 |
| FAZA I: Mbledhja e kërkesave dhe validimi i proceseve | 11 |
| FAZA II: Përgatitja e mjedisit teknik për instalimin dhe testimin e sistemit | 11 |
| FAZA III: Zhvillimi i sistemit | 11 |
| FAZA IV: Testimi | 12 |
| FAZA V: Trajnim dhe instalim i versionit perfundimtar | 12 |
| FAZA VI: Mirëmbajtje..... | 12 |
| 5. LOGJISTIKA DHE KOHA..... | 12 |
| 5.1. Vendndodhja | 12 |
| 5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave | 12 |
| 6. RAPORTIMI | 12 |
| 6.1. Kërkesat e Raportimin..... | 12 |
| 6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve..... | 13 |
| 7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA | 13 |
| 8. GARANCIA | 13 |
| 9. MIRËMBAJTJA..... | 13 |

| | |
|--|----|
| 10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT | 14 |
| 11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT | 15 |
| 12. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT | 16 |
| 13.1. Funksionalitete dhe Bllokskema | 17 |
| 13.2 Fazat e realizimit..... | 17 |
| 13.3 Modelimi dhe Dizënjimi i Bazave të të Dhënave | 18 |
| 13.3.1 Dizënjimi Logjik dhe konceptual | 18 |
| 13.3.2 Integrimi i Pamjes | 18 |
| 13.3.3 Dizënjimi ne nivel te ulet i databazes | 18 |
| 13.3.4 Implementimi final..... | 18 |
| 13.4 TIPOLOGJIA E ASETIVE | 18 |
| 13.5 MODULET FUNKSIONALE PER MENAXHIMIN E ASETIVE..... | 19 |
| Modulet softëare te sistemit Eëb qe duhet te shtrijne funksionalitetin e tyre per te gjitha Institucionet e Varesise jane: | 19 |
| Moduli i Hapesirave publike, per: | 19 |
| Moduli i Profileve te Aseteve dhe Publikimi, per: | 19 |
| Add on per aplikacionin Mobile per lidhjen e me modulin e Menaxhimit Geospatial (GIS) | 20 |
| 13.6. RAPORTE | 20 |
| 13.7 HEDHJA E TË DHËNAVE NË SISTEM PER MODULET E REJA FUNKSIONALE..... | 20 |
| Të dhënat e përgjithshme të asetit | 20 |
| Të dhënat e pronësisë dhe të përdorimit. | 21 |
| Numri i asetëve qe vlerësohet se duhet te regjistrohen sipas tipit: | 21 |
| BAZA E TE DHËNAVE | 22 |
| APLIKACIONI MOBILE | 22 |
| ZGJERIMI | 23 |
| 14. KËRKESAT TEKNIKE | 23 |

1. HYRJE

1.1.Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë/ Bashkia Tiranë

1.2.Historiku

Kërkesat për performancë më të lartë dhe pritshmëritë e sotme që bashkitë të arrijnë më shumë rezultate me buxhete të reduktuara, nxisin nevojën e optimizimit të burimeve dhe proceseve për përdorimin e tyre. Për arsye strategjike, operacionale dhe financiare, menaxhimi i asetëve është duke u bërë një faktor gjithnjë e më i rëndësishëm i vendimmarrjes për qeverisjen vendore.

Tipet e asetëve që menaxhohen nga bashkia e Tiranës dhe sfidat lidhur me to, dhe veçanërisht kërkesa për utilizim të tyre nga qytetarët dhe bizneset e bëjnë të pamundur arritjen e objektivave pa një sistem të mirëfilltë për menaxhimin e asetëve.

Bashkia Tirane eshte ne proces implementimi te nje projekti per menaxhimin e asetëve te saj. Menaxhimi i asetëve te Institucioneve te Varesise do te jete i lidhur me te, me objektiva dhe qellime te ngjashme.

Institucionet e Varesise qe do te perfshihen ne kete projekt:

- Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit
- Agjencia per Mbrojtjen e Konsumatorit
- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
- Ndermarrja e Sherbimeve Funerale
- Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit
- Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
- Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit
- Drejtoria e Konvikteve
- Shkolla Luigj Gurakuqi
- Qendra Sociale Multidisiplinare
- Qendra komunitare "Të qëndrojmë së bashku"
- Qendra Sociale "Shtëpia e Përbashkët"
- Qendra Komunitare "Shkoze"
- Tirana Parking
- Qendra Kulturore " Tirana"
- Klubi Sportiv Tirana
- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave Tarifa Vendore
- Agjencia e Adminsitrimin te Tregjeve

1.3.Situata Aktuale në Sektor

Menaxhimi dhe raportimi i hapur dhe efektiv mbi resurset e pronave publike është një aspekt i rëndësishëm i besimit të komunitetit. Në shumë raste, këto janë bërë shkak për shqetësime të konsiderueshme rreth dyshimeve për keqpërdorim, abuzim ose korrupsion, aktual apo potencial veçanërisht në lidhje me shpërdorimin dhe asgjësimin e pronës publike.

Kjo situatë ekzistuese e bën të domosdoshëm krijimin e një sistemi i cili do të krijonte mjetet për dixhitalizimin dhe administrimin e inventarizimit, regjistrimit dhe përdorimit të aseteve të Institucioneve të Varësisë të Bashkisë Tirane.

Aktualisht këto Institucione kanë në posedim një numër të konsiderueshëm asetesh, të regjistruara në format excel-i dhe në formë shkresore në vite, përmes procedurave të brendshme të miratuara të regjistrimit dhe ruajtjes së tyre, në kategoritë:

- Ndërtesa dhe troje
- Rrugë dhe trotuare
- Sheshet publike
- Godina administrative, kulturore-sportive, arsimore, ekonomike etj.

Sfidat me të cilat përballen Institucionet e Varësisë:

- Nuk ekziston një bazë të dhënash e unifikuar për regjistrimin e aseteve, kategorizimin e tyre dhe ruajtjen e informacioneve të detajuara për çdo aset
- Nevojitet një verifikim ligjor i aseteve në pronësi të Institucioneve të Varësisë, veçanërisht pas reformës territoriale. I tillë verifikim është i vështirë për t'u realizuar me letra apo me excel.
- Në mungesë të të dhënave të detajuara dhe të përditësuara të aseteve, është e vështirë të merren vendime mbi shfrytëzimin optimal të tyre, kostot e mirëmbajtjes apo qëllimet e përdorimit.
- Me ndërrimin e stafëve, rrezikohet të humbasë njohuria specifike dhe historiku i asetit, që kërkohen për administrimin dhe mirëmbajtjen e aseteve të caktuara
- Nevojiten procese të mirëfillta që mbledhin dhe shfrytëzojnë të dhëna financiare dhe gjeohapësinore për asetet
- Kërkohet rritje e nivelit të transparencës ndaj qytetarëve dhe bizneseve, lidhur me regjistrin dhe shfrytëzimin e aseteve

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit si vijon:

- Përfshirja e aseteve të institucioneve të varësisë, me të gjitha informacionet e nevojshme për menaxhimin e aseteve, për të gjitha Institucionet e Varësisë së Bashkisë Tiranë, në databazën e unifikuar të sistemit të menaxhimit të aseteve të Bashkisë.

- Ndërtimi i moduleve aplikative që do ndihmojnë në planifikimin e përdorimit të aseteve nga Institucionet e Varësisë.
- Informim transparent dhe në kohë reale përmes publikimit të informacionit për të interesuarit;
- Saktësi dhe shkurtrim i rëndësishëm i kohës së nevojshme për veprimet e palëve të interesuara;
- Krijimin dhe përdorimin e të dhënave historike për të kryer zëvendësimet dhe mirëmbajtje në kohën e duhur;

2.2. Qëllimi

Qëllimi(et) i kësaj kontrate është/janë si më poshtë:

Ndërtimi i moduleve aplikative dhe të bazës së të dhënave në sistemin e menaxhimit të aseteve, që do të përdoren nga Institucionet e Varesisë së Bashkisë Tiranë, dhe që do të bëjnë të mundur përpunimin e të dhënave dhe menaxhimin e dokumentacionit.

Konsolidimi i procedurave, profileve të përdoruesve dhe përgjegjësive të personelit Institucioneve në Varësi të Bashkisë Tiranë. për të mundur verifikimin e vazhdueshëm dhe përditësimin e informacionit për çdo transaksion që do të menaxhohet nga modulet e aseteve të këtyre institucioneve.

Konsolidimi i procedurave dhe profileve të përdoruesve për akses publik në informacionin që do të autorizohet për publikim.

Sistemi funksional duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

2.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori

Rezultatet e pritshme që duhet të arrihen nga Kontraktori në kuadër të këtij projekti do të jenë:

- Kontraktori duhet të konfirmojë bashkarisht me Bashkinë Tiranë dhe Institucionet e Varesisë të bashkisë Tiranë funksionet që do përmbajë sistemi, bazuar në objektivat e projektit;
- Kontraktori duhet të zhvillojë modulet dhe funksionalitetet e reja të sistemit softëare dhe të testojë në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe Institucionet e Varesisë të Bashkisë Tiranë në përputhje me kërkesat e paracaktuara.
- Kontraktori duhet të implementojë modulet software në infrastrukturën hostuese të Bashkisë Tiranë
- Kontraktori, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe Institucionet e Varesisë duhet të përgatisë module trajnimi dhe të zhvillojë trajnimin e punonjësve në lidhje me përdorimin e sistemit;
- Kontraktori në bashkëpunim me bashkinë Tiranë duhet të përcaktojë dhe të ndjeke

procedurat e nevojshme për mirëmbajtje.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

Bashkia Tiranë presupozon që sistemi elektronik i inventarizimit, regjistrimit dhe përdorimit të aseteve të Institucioneve të Varësisë bashkë me të gjitha të dhënat që nevojiten për funksionimin e tij do të instalohen pranë infrastrukturës ekzistuese të Bashkisë Tiranë dhe Institucioneve të Varësisë

Do të ngrihet një grup pune i posacëm me të gjitha palet te cilët do të jenë përgjegjes për të gjitha fazat e zhvillimit të projektit.

3.2. Risqet

- Detaje ende të papërcaktuara të funksionimit të Institucioneve të Varesise se Bashkisë ne lidhje me qëllimin e projektit
- Vështirësi në mbledhjen e informacioneve për të gjitha asetet nga stafi i Institucioneve të varësisë.
- Vendimmarrje e vonuar ose e munguar lidhur me procese të caktuara për administrimin e aseteve;
- Saktësia e pamjaftueshme e të dhënave të përdorura nga sistemi
- Mungese e suportimit të mjaftueshem të sistemit nga aktorët e tjerë ndërveprues.
- Moslinearizim i procedurave dhe profileve të përdoruesve në lidhje me menaxhimin e aseteve nga njeri Institucion në tjetrin.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore, e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen nëpërmjet këtij projekti është e listuar më poshtë:

- Ligji nr.8744, datë 22.2.2001 “për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”
- Ligji nr.8743, datë 22.2.2001 “për pronat e paluajtshme të shtetit”.
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.
- VKM nr.378, date 12.8.1999 “per kalimin e se drejtes te perfaqesuesit te pronarit per disa objekte prone publike, organeve te qeverisjes vendore”.
- VKM nr. 500, date 14.8.2001 “per inventarizimin e pronave te paluajtshme shteterore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore”.
- Udhëzimi Nr. 30, Ministria e Financave, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Bashkia Tiranë synon që menaxhimin e standardizuar të aseteve të saj ta shtrihe në të gjitha institucionet e saj të varesise, të suportuar nga një bazë e dhënash unike, modulare dhe e centralizuar në pikepamje të modelit dhe menaxhimit, që do të njehsojë të gjitha informacionet ekzistuese dhe integrojë sisteme të treta që do të vihen në shërbim të ofrimit të një shërbimi efikas, të saktë dhe të shpejtë drejt palëve të interesuara, me qëllim rritjen e potencialit dhe efikasitetit të përdorimit të aseteve të këtyre institucioneve të varesise.

4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Bashkia Tiranë, Institucionet e Varësisë të bashkisë Tirane

4.1.3. Grupet e synuara

1. Staf i Institucioneve të Varësisë të Bashkisë Tiranë

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit

Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

Ndermarrja e Shërbimeve Funerale

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit

Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit

Drejtoria e Konvikteve

Shkolla Luigj Gurakuqi

Qendra Sociale Multidisiplinare

Qendra komunitare "Të qëndrojmë së bashku"

Qendra Sociale "Shtëpia e Përbashkët"

Qendra Komunitare "Shkoze"

Tirana Parking

Qendra Kulturore "Tirana"

Klubi Sportiv Tirana

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave Tarifa Vendore

Agjencia e Administritimit të Tregjeve

2. Drejtoritë më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Juridike e Aseteve dhe Licensimit

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

3. Publiku (bizneset dhe qytetarët)

4.1.4. Siguria e sistemit

Sistemi elektronik i inventarizimit, regjistrimit dhe përdorimit të asetëve të Institucioneve të Varësisë do të administrohet nga punonjësit e Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë, dhe do të bëhet i mundur sipas politikave të sigurisë të saj, përmes krijimit të profileve të përdoruesve, me te derjtat dhe autorizimet specifike për secilin.

Sistemi në përdorim nga Institucionet do të implementojë standardet më të mira të sigurisë të cilat do të jenë në disa nivele:

- Në nivel aplikimi, ku do të bëhet e mundur që autentifikimi i përdoruesve të realizohet nëpërmjet protokollit që do të mundësojë një siguri të lartë në ruajtjen e të dhënave;
- Në nivel databaze, ku të dhënat e rëndësishme në lidhje me fjalëkalimet e përdoruesve do të ruhen të enkriptuara duke përjashtuar në këtë mënyrë mundësinë e marrjes së tyre. Gjithashtu, duke qenë se përdoruesit do të jenë të ruajtur në një tabelë të veçantë në databazë nuk do të ketë nevojë që kredencialet e administrimit të databazës të shpërndahen në persona të tjerë përveç administruesit IT të databazës.
- Administrimi i çdo përdoruesi do të realizohet nëpërmjet aplikimit, i cili do të jetë i pajisur me një modul të veçantë të administrimit të përdoruesve. Nëpërmjet këtij moduli do të mundësohet krijimi i përdoruesve të rinj dhe menaxhimi i atyre ekzistues. Ky modul do të jetë i aksesueshëm vetëm nga administratorët e aplikimit dhe këta të fundit do të kenë mundësinë për krijimin dhe menaxhimin e të drejtave të çdo përdoruesi nëpërmjet implementimit të roleve, autorizimeve, të drejtave selektive mbi të dhënat e aplikimit, etj. (Rolet dhe të drejtat për secilin janë të detajuara në kapitullin e kërkesave funksionale).

Kontraktori është i detyruar të zbatojë rregulloret e sigurisë të nxjerra nga Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Kompjuterike (ALCIRT). Niveli i kërkuar i sigurisë duhet të përcaktohet në përputhje me objektivat e sigurisë së informacionit nëpërmjet parametrave të integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë si më poshtë:

- Disponueshmëria D1, 90% (ndërprerja totale e lejueshme në një javë ~ 24 orë); vonesa e lejueshme e kohës së reagimit të kërkuar në pikun e ngarkesës - orë (1÷10);
- Integriteti I1, ekzistenca e ndryshimeve apo dëmtimeve është e zbulueshme; verifikimi i saktësisë, integriteti dhe përditësimi i informacionit në raste të veçanta dhe sipas nevojës;
- Konfidencialiteti K0, informacioni publik: aksesimi i informacionit nuk është i kufizuar (p.sh. të gjithë personat e interesuar kanë të drejtë të lexojnë të dhënat); e drejta për të ndryshuar të dhënat përcaktohet nga kërkesat e integritetit.

Përcaktimi i nivelit të sigurisë si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit është bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

| Disponueshmëria | Integriteti | Konfidencialiteti | Niveli i Sigurisë |
|--|--|--|---------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> D0 | <input type="checkbox"/> I0 | <input type="checkbox"/> K0 | |
| <input checked="" type="checkbox"/> D1 | <input type="checkbox"/> I1 | <input checked="" type="checkbox"/> K1 | <input type="checkbox"/> U |
| <input type="checkbox"/> D2 | <input checked="" type="checkbox"/> I2 | <input type="checkbox"/> K2 | <input checked="" type="checkbox"/> M |
| <input type="checkbox"/> D3 | <input type="checkbox"/> I3 | | <input type="checkbox"/> L |

- Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.
- Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmëria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.
- Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmëria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

4.2. Detyrat specifike

FAZA I: Mbledhja e kërkesave dhe validimi i proceseve

- Konfirmimi i kërkesave kryesore të administrimit të funksionaliteteve të sistemit në bashkëpunim me grupin e punës.;
- Analizim dokumentash;
- Referime në kuadrin ligjor.
- Vlerësimi i të gjitha mundësive për zhvillimin e sistemit
- Përcaktimi i hapave të zhvillimit dhe afateve kohore të tyre
- Hartimi i diagramave mbi proceset bazike

FAZA II: Përgatitja e mjedisit teknik për instalimin dhe testimin e sistemit

- Hartimi i planit për instalimin e moduleve software si pjese integrale e sistemit te menaxhimit te aseteve, ne ambjentin e bashkise Tirane, duke patur në fokus vazhdimin e përdorimit te teknologjive të virtualizimit,
- Përgatitja e mjedisit teknik hostues

FAZA III: Zhvillimi i sistemit

- Ndërtimi/zhvillimi i moduleve software sipas dizenjimit paraprak
- Testimi i brendshem dhe integrimi i moduleve me tërësinë e komponentëve dhe të dhënave të sistemit

FAZA IV: Testimi

- Instalim i moduleve software ne versionin test dhe integrimi me pjesen tjeter te sistemit
- Vendosja e qëllimit të testimit, të dhënat hyrëse, proceset për t'u zhvilluar
- Testimi i sistemit, dokumentimi i rezultateve të tij
- Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre
- Ritestim i procesve të ndryshuara

FAZA V: Trajnim dhe instalim i versionit perfundimtar

- Zhvillimi i trajnimeve me qëllim familjarizimin e stafit me sistemin
- Validim dhe marrje informacioni të mëtejshëm mbi punën e bërë
- Konfigurimi i pajisjeve të infrastrukturës mbështetëse në bashki
- Integrimi me rrjetin dhe shërbimet ekzistuese
- Instalim i sistemit në ambjentin ku do funksionojë
- Suport në ndjekjen e praktikave reale

FAZA VI: Mirëmbajtje

- Mirëmbajtje e sistemit tërësor sipas dispozitave të VKM-së nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Institucionet e Varësisë, Instalimi i sistemit ne Bashkia Tiranë

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës, dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nisur nga kjo datë dhe mirëmbajtja për 4 vjet pas implementimit.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktori do të paraqesë raportet e mëposhtme në Shqip në origjinal dhe 2 kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet pas një jave nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktori duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura.

Kontraktori duhet të vazhdojë me punën e tij derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar

- **Raporti i analizës së kërkesave dhe validimit të proceseve të punës** 1 muaj pas fillimit të implementimit
- **Drafti i raportit përfundimtar** i faqeve maksimale 12 (teksti kryesor, duke përfshirë anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 7 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Modulet e reja funksionale software të menaxhimit të aseteve për bashkinë Tiranë dhe institucionet e varesise do të duhet të integrohen me

- sistemin qendror përkrahës të menaxhimit të aseteve, si pjesë integrale e tij
- me sistemin lokal të emailit të Bashkisë Tiranë dhe Institucioneve të Varësisë për të mundësuar një rrugë të dytë komunikimi të hallkave pjesëmarrëse në proces, përveç asaj të komunikimit brenda strukturave të vetë sistemit.
- me sistemin financiar të Bashkisë Tiranë dhe Institucioneve të Varësisë për shkëmbim të dhënash financiare rreth aseteve (planet e amortizimit dhe vlerat e mbetura).
- me sisteme të tjera të qeverisë qendrore dhe sisteme të tjera lokale në varësi të kërkesave për vlerësim në kohë sa më të shpejtë të dhenave të aseteve, përmes integritetit të unifikuar të sistemit të menaxhimit të aseteve të Bashkisë

8. GARANCIA

Garancia e funksionimit të moduleve me sistemin si një i tere do të jetë jo më pak se një vit pas dorëzimit përfundimtar.

9. MIRËMBAJTJA

Bazuar në VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, periudha e mirëmbajtjes për këto module do të jetë 4 vjet pas dorëzimit

perfundimtar.

Në rast se gjatë periudhës së mirëmbajtjes do të identifikohen nga Kontraktuesi shërbime të reja për t'u shtuar në sistemin informatik, implementimi i tyre duhet të parashikohet në marrëveshjen e mirëmbajtjes.

10.PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

| Nr. | Emërtimi | Sasia | Çmimi/njësi | Çmimi |
|-----|---|-------|-------------|-------|
| 1 | Linearizimi i menaxhimit të aseteve në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë (zhvillim modulesh software, instalim) | 1 | | |
| 2 | Trajnimi i përdoruesve | 1 | | |
| 3 | Aplikacion Mobile | 1 | | |
| 4 | Mirëmbajtje vjetore | 4 | | |
| | Totali pa TVSH | | | |
| | TVSH (20%) | | | |
| | TOTALI ME TVSH (LEKË) | | | |

11.AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

| Nr. | Emërtimi i Fazës / Periudha kohore | M1 | M2 | M3 | M4 | M5 | M6 | M7 | M8 | M9 | M10 | M11 | M12 | M13-M60 |
|-----|--|----|----|----|----|----|----|----|----|----|-----|-----|-----|---------|
| 1 | Mbledhja e kërkesave dhe validimi i proceseve | ■ | ■ | | | | | | | | | | | |
| 2 | Faza e përgatitjes së mjedisit teknik për instalimin dhe testimin e sistemit | | ■ | | | | | | | | | | | |
| 3 | Faza e zhvillimit të moduleve softëare | | | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | | | | | |
| 4 | Faza e testimit të moduleve të sistemit në teresinë e tyre | | | | | | | | | ■ | ■ | | | |
| 5 | Trajnimi i përdoruesve dhe instalimi perfundimtar | | | | | | | | | | ■ | ■ | | |
| 6 | Marrja në dorëzim | | | | | | | | | | | | ■ | |
| 7 | Fillimi i procesit të mirëmbajtjes | | | | | | | | | | | | | ■ |

12.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Sistemi do të dorëzohet i shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar.

Të gjitha të drejtat që i perkasin Operatorit Ekonomik mbi kodin burim dhe dokumentacionin teknik, do t'i kalojnë Autoritetit Kontraktor ne format elektronik dhe ne leter.

13.KËRKESAT FUNKSIONALE

Implementimi i moduleve te reja funksionale do të mundësojë:

- Krijimi/Menaxhimi i një profili dixhital unik i cdo asetit gjatë gjithë ciklit jetësor të tij për të gjitha Institucionet e Varesise se Bashkise Tirane.(regjistrim, modifikim, cregjistrim, përditësim të dhënash me sistemin pasesor dhe me sisteme të tjera);
- Platforme që reflekton ndryshimet e mundshme të bazes ligjore dhe operacionale, për të arritur në një sistem me një informacion dinamik, për të gjithë institucionet e varesise, duke marrë parasysh specifikat e secilit prej tyre.
- Platformë e plotë për menaxhimin e asetëve fizike në një vend të vetëm;
- Integrim me sistemin e kontabilitetit të Bashkisë Tiranë dhe Institucioneve të Varësisë për shkëmbim të dhënash financiare rreth asetëve (planet e amortizimit dhe vlerat e mbetura) si dhe me sisteme të tjera të qeverisë qendrore dhe sisteme të tjera lokale në varësi të kërkesave, për vlerësim në kohë reale të të dhënave të tyre;
- Vizibilitet analitik për të gjitha palët e interesuara, veçanërisht drejtuesit e Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë;
- Vizibilitet gjeospacial për Asetet e cdo Institucioni, duke marrë parasysh në mënyrë të veçantë specifikat e secilit prej tyre.
- Mundësi për konsolidim dhe aplikimin e praktikave më të mira për administrimin e asetëve, inventarizimin e tyre dhe administrimin e personelit që kujdeset për to;
- Gjenerimin e raporteve dhe statistikave të ndryshme bazuar mbi konsolidimin e të dhënave në kohë reale, për cdo Institucion, sipas specifikave të tij.
- Një opsion i veçantë për integrimin me sisteme të tjera ekzistuese dhe mundësi integrimesh për sisteme të tjera;
- Administrim i të drejtave dhe roleve të përdoruesve në sistem, për cdo institucion, sipas specifikave të tij. Në varësi të rolit që ka përdoruesi në stafin e Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë, do t'i atribuohen edhe të drejta mbi shërbime apo nënmenu brenda sistemit, si dhe mbi asetet e grupit asetesh apo profilet asetesh që i perkasin Institucionit ku ai bën pjesë. Sistemi duhet të mundësojë të drejta mbi role, ku një përdorues mund të ketë më shumë se një rol. Zgjidhja softëare duhet të administrojë dhe të përshtatet strukturës organike të cdo Institucioni.
- Monitorimi nëpërmjet log-eve të sistemit, auditimi, për cdo Institucion sipas specifikave të tij. Sistemi do të mundësojë monitorimin e çdo veprimi të kryer mbi të, në formën e log-eve. Loge-t mund të aksesohen dhe prej tyre të nxirren

monitorime të ndryshme, filtruar sipas përdoruesit, Institucionit, datës dhe veprimeve mbi sistemin.

- Menaxhimi i kushteve të mirëmbajtjes së aseteve të Institucioneve të Varesise
- Menaxhimi i konsolidimit të titujve të pronësise mbi pronat e paluajtshme, përmes suportit që do të japë sistemi informatik

13.1. Funkcionalitete dhe Blllokskema

Kërkesat funksionale të domosdoshme që kërkohet të implementohen për Institucionet e Varesise janë paraqitur me poshte:




Figura 1 paraqet modulet kryesore që do integrohen me sistemin bazë për ofrimin e funksionalitetit për Institucionet e Varesise

13.2 Fazat e realizimit

Do të ndiqen këto faza për realizimin e projektit:

- Institucionet e Varesise do të mbledhin të dhënat e detajuara për të gjitha asetet, secili sipas listës së tij.
- Institucionet e Varesise do të bëjnë një verifikim të statusit ligjor të secilit aset.
- Bashkia e Tiranës do të bëjë verifikim të listës së aseteve dhe kontroll për kryqezime të mundshme të institucionit menaxhues, apo asete me varesi të dyfishte.
- Do të bëhet një listë e profileve të aseteve.
- Do të bëhet kartelë e detajuar për secilin aset, për çdo Institucion, kartela të cilat do të hidhen si data entry në një databazë të perkohshme/ në versionin fillestar të moduleve.

- Do të hartohen procedurat e menaxhimit të çdo profili asetesh të cilat me pas do të lidhen me kartelat e çdo asemi dhe çdo institucioni.
- Sistemi softëare me dorezimin e tij do të shërbejë si dritare e vetme për menaxhimin e aseteve.

13.3 Modelimi dhe Dizënjimi i Bazave të të Dhënave

Nga operatori ekonomik kërkohet që të kryhen këto aktivitete si më poshtë:

13.3.1 Dizënjimi Logjik dhe konceptual

- Konsolidim i Skemes së diagramës konceptuale të modelit të të dhënave të përdorur në sistemin pauesor të bashkisë dhe përshtatje për institucionet e varesisë. Sa më sipër përmes teknikave ER ose UML.
- Transformimi i modelit në tabelë
- Analiza e tipareve të ndryshme të çdo nënseti (semantika për marrëdhëniet opsionale, marrëdhëniet trinare, supertipet dhe nëntipet)

13.3.2 Integrimi i Pamjes

- Konsolidimi i pamjes për të gjithë asetet, në një model të vetëm, duke përdorur metoda si sinonimet, agregimi dhe përgjithësimi

13.3.3 Dizënjimi në nivel të ulët i databazës

- Përshtatje e indekseve për particionimin dhe grumbullimin e të dhënave.
- Optimizimi i databazës për rritjen e performancës.
- Integriteti i të dhënave dhe tabelave të krijuara.
- Integriteti në lidhje me pjesën tjetër të databazës së aseteve

13.3.4 Implementimi final

- Kompletimi i databazës
- Testimi, monitorimi në arrihen kërkesat e performancës.
- Modifikime.
- Procedurat e administrimit

13.4 TIPOLOGJIA E ASETEVE

Tipet e aseteve që duhet të menaxhohen nga modulet e Institucioneve të Varesisë janë:

- pasuritë e patundshme
- mobiljet dhe pajisjet mbështetëse
- Rrjetat dhe telekomunikacioni
- Mjetet motorrike dhe mirëmbajtjen e tyre
- Kontratat e qerave

Sistemi në formën e vet modulare duhet të jetë i hapur për veprimtari të mëtejshme në

menaxhimin e seteve apo aktiviteteve edhe te natyrave te tjera, si:

- lidhja e menaxhimit te pasurive te paluajtshme me hapësiren në plan strategjik, vleresim i perdorimit efikas te saj, vizion i plote mbi pasurite e paluajtshme dhe ndikimin e tyre ne hapesire, zbatimin e rregulloreve te perdorimit te hapesires e keshtu me rradhe.
- menaxhimin e aseteve njerëzore dhe profesionale
- utiliteteteve si energjia dhe uji
- marrëdhëniet mes banoreve dhe administrimit te banesave

Modulet softëare, permes nje perqasje integruese, do te suportojne si nje e tere aktivitetin e mirembajtjes dhe kujdesit ndaj aseteve, duke siguruar preventivimin dhe raportimin teknik dhe ekonomik të shërbimeve te marra nga pale te treta.

Modulet softëare do te perdorin mjete ndihmese informatike qe ne perdorim nga Institucionet e varesise, si aplikacione te specializuar per dizenjimin grafik dhe dokuemntacionin, planet dhe projektet e ndertesave dhe rrugeve, softëare per dizenjimin e rrjetave te telefkomunikacionit etj (BIM, BMS -BAS, NOC, GIS, CAD, etj.)

13.5 MODULET FUNKSIONALE PER MENAXHIMIN E ASETEVE

Modulet softëare te sistemit Ëeb qe duhet te shtrijne funksionalitetin e tyre per te gjitha Institucionet e Varesise jane:

Moduli i Hapesirave publike, per:

- optimizim te planifikimit dhe parashikimit te hapësirave
- planifikim afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë
- planifikim strategjik
 - planifikim te kerkesave per ndertim
 - Panifikim te infrastruktures dhe utiliteteve dhe sherbimeve
 - Transaksionet
 - Analize urbane dhe rurale
 - Harta GIS permes funksionesh shtese te nje GIS serveri Ëeb te integruar

Moduli i Profileve te Aseteve dhe Publikimi, per:

- lidhje te investimeve me profilet e aseteve
- parashikim dinamik te investimeve ne profile te caktuar
- sigurimi i kapitaleve
- Aplikacion Mobile per perdorim nga stafi menaxhues i aseteve
- Qarkullimi
- Zhvleresimi
- Analiza financiare
- Ndervaresite e profileve
- Historiku i profileve
- Shfrytezimi dhe efienca e saj

- Gjurmimi
- Sigurimi i qendrushmerise dhe perputhshmerise financiare me profilin e specifik te kriterëve

Add on per aplikacionin Mobile per lidhjen e me modulin e Menaxhimit Geospatial (GIS)

Permes ketij funksioni do te behet lidhja e aplikacionit Mobile me Modulin GIS per te mundesuar ne kohe reale per punonjesit e verifikimit ne terren te te dhenave gjeospaciale dhe vizualizimin e asetëve permes aplikacionit Mobile.

Shtimi i disa layerave ne modulin GIS si :

- Compliance
- Vleresimi i risqeve
- Gadishmeria per emergjenca
- Vazhdimesia e punes
- Sherbimet me te aferta
- Rrjetat

Shtimi i funksionit te gjenerimit automatik të gjeo-referencave për të gjitha pasuritë, ndërtesat dhe asetet e Institucioneve të Varësisë.

Shtimi i funksionit te sinkronizimit në formë dinamike të të gjitha transaksioneve të pronave, ndërtesave dhe të dhënave të asetëve

Moduli i avancuar i perdoruesve

Permes ketij moduli do te behet menaxhimi i integruar i perdoruesve te sistemit, profilet, te drejtat dhe autorizimet sipas rolit.

Kerkohe integrim me sistemin ekzistues te kontrollit te perdoruesve (LDAP)

13.6. RAPORTE

Raportet që duhet të gjenerohen janë:

- Raport mbi statusin e asetëve te cdo profili, varesite e tyre dhe ndikimin te njeri-tjetri ne fome dinamike;
- Raport mbi perdorimin edhe shfrytezimin dhe eficiencen e saj, në periudha të ndryshme kohore;
- Raport mbi aktivitetin mirembajtjes dhe preventiv per cdo aset dhe profil aseti.
- Raporte të ndryshme te krijuara me kerkese., ne fazen e analizes se kerkesave dhe gjate implementimit.

13.7 HEDHJA E TË DHËNAVE NË SISTEM PER MODULET E REJA FUNKSIONALE

Të dhënat e përgjithshme të asetit

Përfshihen informacionet bazë mbi asetin:

- Numri Identifikues i Regjistrimit të Asetit
- Zona kadastrale
- Emri i Asetit
- Lloji i Kategorisë së Asetit
- Lloji i Asetit
- Vlerësimi mbi vlerën e asetit (në Lekë)
- Vendndodhja
- Institucioni/Enti me përgjegjësi administrimi.
- Institucioni/Enti përdorues.
- Statusi juridik i përdorimit
- Përmasat e Parcelës së tokës në m2
- Përmasat e ndërtesës në m2
- Numri i kateve
- Gjendja e Regjistrimit
- Vëllimi
- Faqja
- Data e Ndërtimit
- Numri i Hartës Treguese

Të dhënat e pronësisë dhe të përdorimit.

Përfshihen informacione për pronësinë mbi asetin dhe se si aktualisht po përdoret ky aset. Fushat e të dhënave në këtë hap përfshijnë:

- Gjendja e pronësisë
- Kufizime (nëse ka)
- Data e transferimit
- Mënyrat e transferimit
- Gjendja e përdorimit
- Nëse aset i është dhënë me kontratë qeraje
 - Emri i qiramarrësit
 - Çmimi për muaj
 - Data e fillimit të kontratës së qirasë
 - Data e përfundimit të kontratës së qirasë
- Ecuria e kontrates, notifikime, etj)
 - Nëse aset i është shitur
 - Emrin e personit/organizatës që ka blerë asetin
 - Çmimin e shitjes
 - Datën e shitjes
 - Komentë

Numri i aseteve që vlerësohet se duhet të regjistrohen sipas tipit:

| Nr | Tipi i asetit | Pershkrim | Sasia |
|----|---------------|-----------|-------|
| 1 | Ndërtesa | | |
| 2 | Rrugë | | |
| 3 | Trotuare | | |
| 4 | Sheshe | | |
| 5 | Kanale | | |
| 6 | Liqen | | |

| | | | |
|-----|----------------------------|--|--|
| 7 | Truall | | |
| 8 | Arë | | |
| 9 | Rrjet telekomunikacioni | | |
| 10 | tubacione | | |
| 11 | Kontrata qeraje | | |
| 12 | Institucionet | | |
| 13. | | | |
| | | | |

BAZA E TE DHENAVE

Profili i cdo aseti duhet te jete i ndertuar ne forme peme, me nivele te modifikueshem dhe te perdorshem sipas cdo specifike te nje aseti apo institucioni.

Nivelet dhe Elementet do te nderlidhen sipas nje modeli te caktuar funksional.

Cdo profil aseti dhe cdo aset do kete atributet dhe karakteristikat qe do te menaxhohen ne brendesi te te gjithë ciklit të jetës së tij.

Regjistrimi i aseteve:

Në kartelën e aktivitetit ku duhet të përfshihen informacionet bazë mbi asetin, përveç tyre do të asenjojnë edhe

- Institucioni/Enti me përgjegjësi administrimi.
- Institucioni/Enti përdorues.
- Statusi juridik i përdorimit

Sistemi duhet të bëjë të mundur eksportin e bazës së të dhënave në mënyra të ndryshme si përshembull: Excel (listë e thjeshtë e pajisjeve dhe informacioneve të nevojshme) dhe Paketa (dosja zip me fotot e pajisjeve dhe skedar Excel me listën totale dhe informacione të nevojshme, të organizuara sipas kriterëve të përcaktuara të filtrimit dhe renditjes). Mënyra e dytë duhet të lejojë përdoruesin të identifikojë në mënyrë të menjëhershme informacionin që mungon, për të gjetur dhe / ose ndryshuar atë.

APLIKACIONI MOBILE

I përshtatshëm për Android, IOS, Windows.

Të mund të gjenerojë një route me destinacion një aset me një vendodhje të caktuar gjeografike.

Te përfshijë gjeolocation të përdoruesit.

Te kete mundesine e funksionimit offline, permes mekanizmave data push apo ekuivalente.

Te kete mundesine e User feeding dhe Ruajtjes se te dhenave te nje sesioni.

Mundesi per mbrojtje nga data leakage.

Aplikacioni mobile do te funksionojë vetem ne Read/Search mode.

Notifikime Real time, dashboard.

Funksionalitete GIS dhe mapping.

Kategorite, profilet, Institucionet ne lista te paracaktuara.

Mundesi per queries ne databaze.

ZGJERIMI

Modulet softëare do jene pjese e nje platforme unike, program i hapur që të parashikojë dhe sigurojë planifikimin, menaxhimin dhe regjistrimin e plotë të hapësirave dhe jo vetëm të menaxhimit të aseteve, por për t'i dhënë zgjidhje në të ardhmen integritit të aplikacioneve shtesë per menaxhimin e shërbimeve të Bashkise Tiranë ne pergjithesi.

Struktura modulare duhet të lejojë që Bashkia Tirane për nevojat e saj të zgjedhë ato aplikacione që i shërbejnë për të menaxhuar në një sistem qendror shërbimet e saj. Struktura duhet të jetë zgjidhje modulare plotësisht e shkallëzuar që të jetë gati për t'u instaluar dhe përshtatur, arkitektura e saj duhet të jetë e hapur për të ofruar lidhje të plotë me kërkesat e mëtejshme të menaxhimit te ndërmarrjeve të Bashkisë Tiranë, të tilla si të sistemeve financiare dhe burimeve njerëzore, Menaxhimit te Projekteve, Buxhetimi etj. për të zgjeruar shërbimet e nevojshme të Bashkisë Tiranë.

14. KËRKESAT TEKNIKE

Per realizimin e ketij projekti do te perdoren pajisjet ekzistuese, te cilat do t'i vihen ne dispozicion operatorit fitues